



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 nen d) si dhe nenit 17 paragrafi 1 nen b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L040 publikuar në Gazetën Zyrtare, Nr.28/2008, dhe sipas Shkresës së MAPL-me nr.020-111/5 të datës 09.03.2020 si dhe kërkesa e MIA me nr.DL-1338-2/2020 të datës 04.03.2020 për Rishqyrtimin-harmonizimin me nenin 9 paragrafi 2 të Ligjit për Planifikim Hapsinor nr.04/L-174 të vendimit o1nr.06-4259/20 të datës 31.01.2020 dhe Shkresës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit nr.zyrtarisht/20 - me propozim-vendim për miratimin e Hartës Zonale për Komunën e Klinës- pas Shkresës së Ministrisë, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e vetë të rregullt të III-të për vitin 2020 të datës 15.05.2020, mori këtë:

V E N D I M

**Për Rishqyrtim të vendimit o1nr.06-4259/20 të datës 31.01.2020
për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Klinës 2020-2028**

- 1. Harmonizohet dhe plotësohet** vendimi bazë për miratim të Hartës Zonale të Komunës së Klinës o1nr.06-4259/20 të datës 31.01.2020 duke pasur për bazë kërkesën nga Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit si dhe kërkesën nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
Vendimi si në piken 1 rishqyrtohet pas fuzionimit të ministrive dhe emërtimi i ri i tyre. Komunës së Klinës i është dashur që të intervenoi në tersi në dokumentin që ka të bëjë me Hartën Zonale dhe të bëjë përshtatjen me kërkesa të reja ku HZ duhet të jenë me emërtimin e ri të Ministrisë.
- 2.** Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazë o1nr.06-4259/20 të miratuar me datën 31.01.2020
- 3.** Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, ky vendim hynë në fuqi 15 dite pas delegimit në autoritetin mbikëqyrës në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenit 16 dhe 17 të Rregullores së MAPL nr.01/2017 Për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave.
- 4.** Me vendim të njoftohen: MAPL, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, kryetari i Komunës si dhe Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

o1Nr. 60-10081/2020
Klinë, me 21.05/2020



Kryesuesi,
Fadil Gashi